

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092

Një ankesë kundër: **K.K. SKENDERAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **643-26-566-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: 001- Sigurimi Fizik i Objekteve të Komunës së Skenderajt

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

M-Gr.Secyurity SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

(Adresa)

Rruga Agim Ramadani Katana, p.n.

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344156338

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Nafije Tahiri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

baki_36@hotmail.com

(Adresa elektronike)

04.05.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtoj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

K.K. SKENDERAJ	
Kodi/Numri	2026/643-26-566-2-1-1/B54-0007628
Emërtimi	001- Sigurimi Fizik i Objekteve të Komunës së Skenderajt
Lloji i dokumentit*	B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara
Lloji i kontratës	2 Shërbime
FPP	93000000-8 Shërbime të ndryshme
Lloji i procedurës	1 Procedurë e hapur
Vlera e parashikuar	790,000.00
Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje	04.05.2026 14:00
Data e njoftimit	29.04.2026
Data e dërgimit	28.04.2026
Ligji	LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS Vendim refuzim i kërkesës për ryshqyrtim date 29.04.2026
Vendimi për refuzim	me date 30.04.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Përmes platformes eprokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po

Jo

Ne proces

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?
Nëse po, ofroni shkurtimisht detajet mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Po

Jo

Sipas përgjigjes së Autoriteti Kontraktues, kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar me se eshte jashta afatiti, mirepo AK ka ndryshuar afatet ne dosjen e tenderit dhe pas korrigjimit, ne kemi parashtruar kerkeses per rishqyrtim Brenda afateve te lejuara.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Bazuar në kërkesat për përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues (AK) në Dosjen e Tenderit, konstatohet se disa prej kërkesave të vendosura janë diskriminuuese, joproportionale dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, përkatësisht me:

- Nenin 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Nenin 7 – Barazia në trajtim / mosdiskriminimi
- Nenin 10 – Mjetet për promovimin e transparencës
- Nenin 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Nenin 68 – Gjendja Ekonomike dhe Financiare
- Nenin 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Nenin 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

1. Paqartësia në dëshmimin e përvojës së punës (3 vite)

Në Dosjen e Tenderit kërkohet që:

- OE të prezantojë minimum 5 punëtorë të certifikuar për mbikëqyrje elektronike dhe një menaxher të certifikuar për OME;

- Të dëshmohet minimum 3 vite përvojë pune përmes CV, kontratës apo marrëveshjes për angazhim.

Megjithatë, AK nuk ka specifikuar në mënyrë të qartë formën e dëshmimit të përvojës së punës (p.sh. përmes Trustit, vërtetimit nga punëdhënësi apo dokumenteve të tjera).

Kjo krijon paqartësi dhe hapësirë për interpretim subjektiv, në kundërshtim me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë, si dhe lejon vlerësim jo të njëtrajtshëm të ofertave.

2. Kërkesa për staf të mbikëqyrjes elektronike pa ekzistuar shërbimi

Në DT kërkohen:

- Minimum 5 punëtorë të certifikuar për mbikëqyrje elektronike;
- Një menaxher i certifikuar për OME.

Ndërkohë, në specifikimet teknike nuk figuron shërbimi i vëzhgimit elektronik të pronës.

Kjo kërkesë është jorelevante me objektin e kontratës dhe përbën kriter artificial dhe kufizues, duke reduktuar konkurrencën dhe duke mos qenë në përputhje me natyrën e kontratës.

3. Kualifikimet e menaxherit të projektit – kërkesa tej ligjit

Kërkohet që menaxheri të ketë:

- Diplomë bachelor ose master;
- 3 vite përvojë pas diplomimit;
- Certifikim për siguri dhe shëndet në punë nga “ministria përkatëse”.

Ligji Nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë nuk e parasheh arsimin universitar si kriter obligativ për këto pozita.

Kjo kërkesë tejkalon kërkesat ligjore dhe vendos barriera të panevojshme për pjesëmarrje, duke kufizuar konkurrencën.

III. Kërkesa

Nga argumentet e cekura më lart, kërkojmë që:

Të nxirret ky:

VENDIM

- Të aprovohet në tërësi si e bazuar kjo ankesë e OE “M-Gr Security SH.P.K.”
- Të korrigjohet Dosja e Tenderit
- Të sqarohen në mënyrë të detajuar kërkesat dhe kriteret në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë
- Lënda të kthehet në rishqyrtim / rivlerësim
- Të korrigjohen kriteret dhe specifikimet teknike në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik

IV. Dëmet materiale

Në pajtueshmëri me kërkesat e Dosjes së Tenderit, konkretisht me seksionin e FDT dhe Aneksin 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme, ne si Operator Ekonomik do të dëmtohem materialisht, pasi kufizimi i padrejtë i konkurrencës na pamundëson pjesëmarrjen e barabartë dhe shkakton humbje në fitimin e parashikuar për këtë kontratë.

V. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Dokumentet gjenden të ngarkuara në sistemin e e-prokurimi